

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE - NATYRORE

DEPARTAMENTI I GJEOGRAFISË

PROGRAMI GJEOGRAFI



PUNIMI I DIPLOMËS MASTER

**Potenciali i përdorimit të tokës për planifikim të
qëndrueshëm në komunën e Gjilanit**

Mentori:

Prof. Asoc. Dr. Ferim Gashi

Kandidati:

Edon Shemsedini

Prishtinë, 2025

Abstrakt

Përdorimi i tokës dhe menaxhimi i saj janë ndër aspektet më të rëndësishme në planifikimin hapësinor dhe zhvillimin e qëndrueshëm të një rajoni. Komuna e Gjilanit, me pozitën e saj të favorshme gjeografike dhe karakteristikat e ndryshme natyrore, përbën një hapësirë me potencial të lartë për zhvillim të organizuar dhe efikas të tokës. Ky punim masteri është i strukturuar në dy kapituj kryesore, të cilëve i paraprijnë abstrakti, hyrja, qëllimi i studimit, pyetjet e hulumtimit, metodologjia e hulumtimit dhe rezultatet e pritura të hulumtimit. Ky studim ka për qëllim të analizojë në detaje mënyrën se si toka është përdorur deri më tani, si dhe të identifikojë mundësitë për një menaxhim më të mirë në të ardhmen. Përmes aplikimit të metodave të avancuara të Sistemeve të Informacionit Gjeografik (GIS) dhe analizës së të dhënave të CORINE Land Cover (CLC) nga Copernicus dhe ESRI Land Use/Land Cover (LU/LC), është realizuar një pasqyrë e qartë e gjendjes aktuale të përdorimit të tokës në këtë komunë. Gjeografia si disiplinë shkencore ka një rol të rëndësishëm në kuptimin e ndërveprimeve hapësinore dhe menaxhimin e territorit. Ajo siguron një qasje të gjerë për analizën e faktorëve natyrorë dhe njerëzorë që ndikojnë në përdorimin e tokës. Duke kombinuar njohuritë gjeografike me teknologjitë moderne të GIS dhe Remote Sensing, është bërë e mundur një vlerësim më i saktë dhe i detajuar i ndryshimeve hapësinore. Remote Sensing, përmes analizës së imazheve satelitore dhe të dhënave multispektrale, ka ndihmuar në identifikimin e modeleve të shfrytëzimit të tokës dhe në monitorimin e ndryshimeve që ndodhin me kalimin e kohës. Në këtë hulumtim, janë analizuar tiparet kryesore të territorit të Gjilanit, duke përfshirë strukturën hapësinore, tipologjinë e mbulueshmërisë së tokës dhe ndryshimet e ndodhura në vite. Rezultatet tregojnë se ka pasur një zgjerim të ndjeshëm të zonave urbane, kryesisht në kurriz të sipërfaqeve bujqësore dhe hapësirave të hapura. Ky trend i urbanizimit të vazhdueshëm është evidentuar përmes krahasimit të të dhënave historike dhe analizës së imazheve satelitore. Për më tepër, në zonat periferike të qytetit, është vënë re një tendencë e fragmentimit të përdorimit të tokës, ku hapësirat bujqësore po humbasin për shkak të ndërtimit të objekteve të reja rezidenciale dhe industriale. Përmes analizës gjeohapësinore, janë evidentuar rajone që mund të shfrytëzohen për zgjerimin e aktiviteteve bujqësore, përmirësimin e infrastrukturës apo krijimin e zonave të reja industriale. Përveç kësaj, studimi ka treguar se në disa pjesë të komunës ekzistojnë hapësira me vlera të veçanta ekologjike, të cilat duhet të ruhen dhe të menaxhohen me kujdes për të siguruar një ekuilibër mes zhvillimit

dhe mbrojtjes së natyrës. Nga analiza e të dhënave të CLC dhe LU/LC, është vërejtur se disa zona të komunës kanë një potencial të lartë për investime në infrastrukturë dhe planifikim urban. Megjithatë, kjo duhet të bëhet me një qasje të kujdesshme, duke marrë parasysh tiparet e terrenit dhe nevojën për një zhvillim të koordinuar. Planifikimi hapësinor është një komponent kyç për të siguruar që rritja urbane të mos ndikojë negativisht në ekosistemin natyror dhe resurset e kufizuara të tokës. Prandaj, rekomandimet e këtij studimi fokusohen në krijimin e strategjive të menaxhimit të tokës që përfshijnë teknologji të avancuara të GIS dhe analiza të thelluara hapësinore për të optimizuar shfrytëzimin e resurseve natyrore. Përdorimi i metodave moderne të analizës hapësinore ka lejuar një vlerësim të saktë të ndryshimeve të ndodhura në territorin e Gjilanit gjatë viteve të fundit. Duke përdorur të dhëna satelitore dhe analiza të ndërlidhura me zhvillimet urbanistike, është krijuar një bazë solide për vendimmarrje në fushën e planifikimit hapësinor. Një nga gjetjet kryesore të këtij studimi është fakti se planifikimi i mëtejshëm duhet të fokusohet në balancimin mes nevojës për zhvillim dhe ruajtjen e tokës për përdorime të tjera të rëndësishme, si bujqësia dhe zonat e gjelbërta. Bazuar në këto gjetje, studimi sugjeron nevojën për hartimin e planeve të integruara hapësinore që mbështeten në analiza të detajuara të përdorimit të tokës dhe ndikimeve të tij. Një menaxhim më i mirë i territorit mund të ndihmojë në krijimin e kushteve për zhvillim të qëndrueshëm, duke mundësuar një shpërndarje më të ekuilibruar të resurseve dhe duke siguruar që territori i komunës të shfrytëzohet në mënyrë optimale. Përdorimi i GIS dhe Remote Sensing paraqitet si një mjet i domosdoshëm për të ndihmuar në realizimin e një planifikimi të suksesshëm dhe për të mbështetur proceset vendimmarrëse mbi zhvillimin e territorit në të ardhmen, dhe është bërë e mundur krijimi i një panorame të qartë mbi ndryshimet dhe tendencat e zhvillimit hapësinor. Në përfundim, ky studim ka nxjerrë në pah rëndësinë e një menaxhimi të kujdesshëm të përdorimit të tokës në Komunën e Gjilanit. Rezultatet e studimit tregojnë se zhvillimi i qëndrueshëm mund të arrihet vetëm përmes një planifikimi të mirëkoordinuar, ku të merren parasysh nevojat e zhvillimit urban, mbrojtja e hapësirave të gjelbra dhe ruajtja e tokave bujqësore. Po ashtu, duhet analizuar ligjet e Republikës së Kosovës, Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor, si dhe të avancohet edhe Direktiva INSPIRE. Përmes integritit të strategjive efikase të planifikimit hapësinor dhe teknologjive të avancuara gjeohapësinore, mund të arrihet një përdorim optimal i tokës, i cili do të kontribuojë në një zhvillim të balancuar dhe të qëndrueshëm për brezat e ardhshëm.

Fjalët kyçe: GIS, Komuna e Gjilanit, Përdorimi i tokës, Planifikimi i qëndrueshëm, Remote Sensing